REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 545 Prot. Lushnje më, 14/01/2026

R E L A C I O N
KESHILLIT BASHKIAK
MBI SHPËRBLIMIN E EKIPIT TË LUSHNJES PËR FEMRA DHE TRAJNERES ERILDA ALLKANJARI

Të nderuar zoterinj këshilltarë!

Volejbolli është një sport ekipor dinamik dhe bashkëpunues, i cili luhet mes dy skuadrave me nga gjashtë lojtarë secila. Qëllimi i lojës është kalimi i topit mbi rrjetë dhe goditja e tij në fushën kundërshtare, duke respektuar rregullat e prekjes së topit (maksimumi tre prekje për çdo skuadër).

Ky sport zhvillon aftësi fizike si shkathtësia, koordinimi, forca dhe shpejtësia, si edhe vlera sociale si puna në grup, disiplina dhe fryma e fair-play. Volejbolli mund të luhet si në ambiente të mbyllura ashtu edhe në natyrë (volejboll plazhi) dhe është i përshtatshëm për të gjitha moshat.
Falë ritmit të shpejtë dhe lojës kolektive, volejbolli është një nga sportet më të dashura dhe më të përhapura në botë.

Ekipi i Volejbollit të Rritura për Femra Lushnje është një ekip me një histori me plotë susksese, të nisur prej vitit 1978 në Krutje. Gjatë ecurisë së saj kjo skuadër pati rezultate të larta duke arritur edhe majat e suksesit në elitën e sportit të volejbollit për femra. Ekipi i Volejbollit të Rritura për Femra, dikur ka qenë njohur gjerësisht edhe si Ekipi i Volejbollit të rritura të Krutjes, si pasojë e vendit të krijimit të këtij ekipi. Ato kanë fituar ndër vite disa trofe. Në kategorinë e II është shpallur kampion në sezonin sportiv 1979-1980. Rezultatet më të mira i ka marrë në periudhen, ku edhe ekipi u shpall kampione e Shqipërisë për të rritura 3 *(tre)* herë, përkatësisht në sezonet sportive: *1995-1996, 1996-1997, 1997-1998*. Dy herë ka fituar Kupën e Shqipërisë, në vitet 1997 dhe 1998. Gjithashtu ka fituar edhe Super Kupën e Shqipërisë në vitin 1997. Në sezonin sportiv 2015-2016 ekipi i volejbollit të rritura për femra, shpallet kampion e kategorisë A-1. Në Dhjetor 2024 Ekipi i Lushnjes merr pjesë në finalet e Kupës së Shqipërisë A-1, ku arriti të fitojë të dyja ndeshjet edhe të shpallet fitues.

Pranë Bashkisë Lushnje ka ardhur kërkesa nga Federata Shqiptare e Volejbollit, për shpërblimin e ekipit të volejbollit së shpallur fitues në Kupën e Shqipërisë për Kategorinë 1 Femra për Sezonin Sportiv 2025-2026 e cila u zhvillua në datat 13-14 Dhjetor 2025 në palestrën *"Arjana Arapi"* në qytetin e Rrëshenit, Ekipi i Volejbollit të Rritura për femra Lushnje, me trajnere znj. Erilda Allkanjari.

Fondi për shpërblimin e Ekipit të Volejbollit të Rritura për Femra Lushnje që ka fituar vendin e parë në Kupën e Shqipërisë për Kategorinë e parë për Femra për Sezonin Sportiv 2025-2026 është **500 000** ***(pesëqind mijë)*** lekë dhe për trajneren znj. Erilda Allkanjari do të shkojë për shpërblim në masën 40% të vlerës që përfiton ekipi ,**200 000** ***(dyqind mijë)*** lekë.

Propozojmë miratimin e ketij projekt-vendimi.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

ERISELDA SEFA

545/1
14.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

PROJEKT-VENDIM

NR. 10 DATË 14/01/2026

MBI SHPËRBLIMIN E EKIPIT TË LUSHNJES PËR FEMRA DHE TRAJNERES ERILDA ALLKANJARI

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/____/2026, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Kryetarja e Bashkisë "**Mbi Shpërblimin e Ekipit Të Lushnjes Për Femra dhe trajneres Erilda Allkanjari"**, si dhe mbeshtetur ne ligjin nr. 139/2015 ***"Për vetëqeverisjen vendore"*** i ndryshuar, neni 54 germa "n" dhe V.K.M. Nr. 789 datë 15.12.2021 ***"Për kriteret, mënyrën e shpërblimint dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre"*** në pikat 4 *(katër)* dhe 7 *(shtatë)*.

V E N D O S I:

1. Të miratojë shpërblimin me vlerë prej **500 000** ***(pesqind mijë)*** lekë për Ekipin e Volejbollit të Lushnjes Për Femra dhe në masën 40% të vlerës që përfiton ekipi **200 000** ***(dyqind mijë)*** lekë për trajneren Erilda Allkanjari.
2. Në Aparatin e Bashkisë do të pakësohet Fondi Rezervë *(me kod 00-01-AF129-604-V491AAA)* në vlerën **700 000 lekë** dhe shtohen në Qëndrën e Kulturës dhe Klubi i Shumësporteve, Programi ***"Disiplinat e ndryshme sportivve të mbështetura"*** *(me kod 00-01-AE129-602-V813AAB)* për **700 000 lekë**
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Qendra Kulturore dhe Klubi Shumësportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ***(dhjetë)*** ditë pas shpalljes.

Drejtor i Q.K.K.S.

Brizida Deryishi

Drejtor Juridik

Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE